



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.481/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj e Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë, të paraqitur kundër subjektit politik, Lëvizja Vetëvendosje LVV, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur më datë 11.02.2025, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN të pabazuara ankesa Anr.481/2025, Anr.482/2025, Anr.485/2025, Anr.489/2025 dhe Anr.491/2025, të datës 09.02.2025, të parashtruara nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar ankesat: Anr.481/2025, Anr.482/2025, Anr.485/2025, Anr.489/2025 dhe Anr.491/2025, më datë 09.02.2025

-Në ankesën A.nr 481/2025 pretendohet se LDK dega në Istog kanë vërejtur se mbështetësit nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, në Qendrën e Votimit në SHFMU "Trepça", kanë shkelur nenin 37 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 i LZP-së dhe neni 8, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 i Rregullores Zgjedhore 07/2024, me rastin e vendosjes së posterit të Albin Kurtit mbi një makinë që gjendet karshi shkollës. Ankesës ka bashkangjitur si provë disa fotografi.

-Në ankesën A.nr 482/2025 pretendohet se LDK dega në Prishtinë ka vërejtur se kryesuesja komisionere nga radhët e LVV-së në Qendrën e Votimit Fakulteti Teknik kanë shkelur nenin 37 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 i LZP-së dhe neni 8, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 i Rregullores Zgjedhore 07/2024, meqë në telefonin e saj pjesë e pasme shihet llogo e LVV (500k-që sipas tyre ka nënkuptimin 500 mijë zemra, që e kanë përdorur si pjesë të sloganit të tyre gjatë gjithë zgjedhjeve bashkë me fjalën cep më cep. Ankesës ka bashkangjitur si provë disa fotografi.

-Në ankesën A.nr 485/2025 pretendohet se LDK dega në Prishtinë ka vërejtur se me rastin e vendosjes së posterit të kandidatit për deputet nga LVV-Albin Kurti përballë qendrës së Votimit në Shkollën e Mesme Profesionale “Gjin Gazulli” është shkelur neni 37 i LZP-së. Ankesës ka bashkangjitur si provë një CD .

-Në ankesën A.nr 489/2025 pretendohet se LDK dega në Istog kanë vërejtur se mbështetësit nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, në Qendrën e Votimit në SHFMU “Trepça”, kanë shkelur nenin 37 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 i LZP-së dhe neni8, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 i Rregullores Zgjedhore 07/2024, me rastin e vendosjes së posterit me llogo të LVV-së brenda qendrës së votimit me sloganin Cep më Cep (ana e djathtë e veturës). Ankesës ka bashkangjitur si provë disa fotografi.

-Në ankesën A.nr 491/2025 pretendohet se LDK dega në Prishtinë kanë vërejtur se kandidati për deputet nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje-Albin Kurti, e ka shkelur nenin 37 paragrafi 1, nënparagrafi 1.2 i LZP-së dhe neni8, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 i Rregullores Zgjedhore 07/2024, me rastin e postimit dhe thirrjeve për votim nga rrjeti i tij social facebook. Ankesë si provë ka bashkangjitur postimin në rrjetin social facebook. Duke u bazuar në gjitha këto që u thanë më lartë dhe provat e bashkangjitura kërkojnë nga PZAP- të shqiptohet masa sanksionuese ndaj subjektit politik LVV.

Përgjigjet në ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), PZAP-i ka pranuar më datë 10.02.2025.

Në përgjigjet në ankesa A.nr.481/2025, A.nr.428/2025, A.nr.425/2025,A.nr.489/2025 dhe A.nr.491/2025 theksohet se nga pretendimet ankimore të ankuesit dhe provat e bashkangjitura në ankesa në asnjë rrethanë nuk mund të provohet fakti se subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje! Ka vepruar në kundërshtim me rregullat zgjedhore. Vetura private si ne foton e bashkangjitur ankesës A.nr.481/2025 shihet e parkuar ne vend parkim jashtë rrethoja te shkollës se lartpërmendur. Lidhur me pretendimet në ankesën A.nr.428/2025 dhe provat e bashkangjitura në përgjigjen në ankesë theksojnë se në foton e bashkangjitur në ankesë nuk mund të vërehet llogoja e Lëvizjes Vetëvendosje (LVV). Lidhur me pretendimet në ankesën A.nr.489/2025 dhe provat e bashkangjitura në përgjigjen në ankesë theksojnë se vetura si pjesë e provave të bashkëngjitura, përveçse nuk identifikohet nëse është të Qendra e Votimit, po ashtu nuk identifikohet dhe dëshmohet se vetura e tillë i përkiste ndonjë

mbështetësi apo aktivisti të LVV dhe në pretendimet në ankesën A.nr.491/2025 dhe prova e bashkangjitur në ankesë theksojnë se Statusi i Kryeministrit në Facebook përmes së cilit bën thirrje ndaj qytetarëve për ta shfrytëzuar të drejtën e tyre të votimit, para se të gjithash, është i bazuar në Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe në asnjë përmbajtje nuk ka thirrje për të votuar ndonjë subjekt të caktuar. Kërkojnë nga PZAP-i, që ankesat e parashtruara nga subjekti politik LDK kundër subjektit të tyre LVV të refuzohen të pabazuara.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr. 01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi I të Ligjit Nr. 05/1,-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si ne vijim: Anr.481/2025, Anr.482/2025, Anr.485/2025, Anr.489/2025 dhe Anr.491/2025 të datës 09.02.2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët Anr.481/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekte i njëjtë politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), kundër subjektit të njëjtë politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) për shkeljen e njëjtë, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se :

Ankesat janë të pabazuara

Paneli pas vlerësimit të ankesave dhe provave të bashkangjitura në ankesë të cituara më lartë si dhe përgjigjeve në ankesë dhe provat e bashkangjitura në të, erdhi në përfundim se pretendimet e ankuesit në ankesat e tyre, se subjekti politik LVV ka bërë veprime të ndaluara para procesit të votimit, ku posterit i Albin Kurtit është vendosur përball shkollës, në Qendrën e Votimit në SHFMU “Trepça” në Istog, në Qendrën e Votimit Fakulteti Teknik në Prishtinë , në telefonin e komisioneres së LVV-së ku shihet llogoja e subjektit LVV, vendosjes së posterit të kandidatit për deputet nga LVV-Albin Kurti përballë qendrës së Votimit në Shkollën e Mesme Profesionale “Gjin Gazulli”, vendosjes së posterit me llogo të LVV-së brenda qendrës së votimit me sloganin Cep më Cep në SHFMU “Trepça” dhe postimit dhe thirrja për votim nga rrjeti i tij social facebook, PZAP-i i vlerëson si të pabazuara dhe të pa argumentuara në fakte dhe dëshmi konkrete, pasi që nga provat e bashkangjitur ankesave nuk vërtetohet se nga subjekti politik LVV është shkelur neni 37 paragrafi 1.1 dhe 1.2 “*Nga hapja e Qendrave të Votimit për votim, e deri në mbylljen e tyre, subjekteve politike, mbështetësve ose kandidatëve të tyre, u ndalohet secili prej veprimeve si më poshtë: 1.1. shpërndarja ose shfaqja në mënyrë tjetër në ndonjërin nga Qendrat e Votimit, dhe oborri i së njëjtës, e çfarëdo lloj materiali me qëllim ndikimi te votuesit; 1.2. bërja e fushatës në çfarëdo mënyre*”.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesave lidhur me shkeljet e pretenduara nga ana e subjektit politik në fjalë, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo pasi që parashtruesi i ankesave, në ankesat e tij ka bashkangjitur postimet e kandidatit në fjalë dhe disa foto, mirëpo me asnjë provë nuk ka mundur të vërtetohen shkeljet e pretenduara, e që sipas vlerësimit të Panelit nuk ka shkelje të heshtjes zgjedhore dhe nuk përbën shkelje të rregullave zgjedhore të përmendura më lartë.

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se ankesat janë të pabazuara pasi që nga provat e ofruara si dëshmi të cilat parashtruesi i ankesave i ka bashkangjitur si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se janë kryer shkeljet e pretenduara. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*", Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesit e ankesave nuk kanë arritur që të vërtetojnë pretendimet e theksuara si më lartë.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 par. 3, neni 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.481/2025 më datën 11.02.2025.



Këshillë Juridike; Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.